



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
- Kuvendi i Komunës-

01 - Nr. 16-27192/12.
Kaçanik, 31.10.2012.

Në bazë të nenit 5, 12.1 dhe 12.2(c) lidhur me nenin 40.2(a) dhe 17 të Ligjit nr. 03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenin 43 pika 3 dhe 4 “Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit 02 – Shpenzimi i Parave Publike”, të nenit 34.5 lidhur me nenin 61.1 të Statutit të Komunës, si dhe nenit 15.1(a) të Rregullores për Punë të Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 31.10.2012, e aprovoj ;

RR E G U L L O R E N **PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE** **DHE TRANSFEREVE**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve buxhetore të komunës nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve për entitet publike dhe jo publike si dhe ndihmat momentale.

Neni 2

Bazuar në shumën e ndarë të mjeteve nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve sipas buxhetit të aprovuar të komunës, Kryetari i Komunës në bazë të kërkesave të arsyshme të parashtruara mund të ndajë mjete financiare buxhetore për entitete publike dhe jo publike si dhe ndihma momentale, në shumën e përcaktuar me këtë rregullore.

Neni 3

Mbështetjet financiare dhe ndihmat momentale sipas kësaj rregulloreje, konsiderohen të gjitha subvencionet dhe transferet e mjeteve që propozohen nga Komisioni përkatës i formuar nga Ekzekutivi Komunal.

Neni 4

Ndihma momentale për entitetet publike (institucionet jo profitabile)

Ndihma momentale për entitetet publike (institucione jo profitabile) përfshinë mbështetjen financiare që iu jepet institucioneve, klubeve sportive, shoqatave dhe shoqërive kulturore dhe jo qeveritare.

Neni 5

Etnitetet publike dhe ato jo publike mund të mbështetën financiarisht edhe për subvencionim në bujqësi dhe në blegtori.

Neni 6

Kërkesat e kompletuara dhe të arsyetura mirë e entiteteve publike për subvencione i drejtohen Kryetarit të Komunës përmes zyrës së pranimi, së bashku me dokumentacionin tjetër të nevojshëm: certifikata mbi regjistrimin dhe numri i llogarisë bankare të entitetit publik.

Neni 7

Kryetari i Komunës pas pranimi të kërkesës, autorizon Komisionin përkatës të formuar për dhënjën e mendimit profesional lidhur me kërkesën e parashtruar. Propozimi i dërgohet për aprovim Kryetarit të komunës. Kryetari aprovon kërkesat e arsyshme të argumentuara me dokumentacion përcjellës.

Neni 8

Kryetari i Komunës merr vendim lidhur me kërkesën e entitetit publik në shumën e përcaktuar me këtë rregullore. Nëse, shuma e kërkuar është më e madhe se në rregullore, i procedohet KPF-së, përkatësisht Kuvendit të komunë për miratim.

Subvencionet për entitetet jopublike (familjet dhe individët)

Neni 9

Në rast të fatkeqësive natyrore, varfërisë së skajshme të familjeve apo individëve, sëmundjeve të rënda që kanë terapi të kushtueshme e që janë banor të komunës së Kaçanikut, bursat e studentëve dhe kompenzimin e plotë apo të pjesërishtëm shpenzimeve të transportit të nxënësëve, Kryetari i Komunës në bazë të kërkesave të arsyetura, ndanë ndihma momentale dhe forma tjera të mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve sipas ndarjeve të aprovuara me buxhet të komunës.

Neni 10

Mbështetja financiare dhe ndihmat momentale nga kategoria e subvencioneve dhe transfere përjashtojnë të gjitha pagesat dhe transferet për qëllime kapitale.

Neni 11

Këto subvencione janë pagesa të njëanshme, jo të këthyeshme, për individët, familjet dhe institucionet joprofitabile.

Neni 12

Kriteret për fitimin e kësaj ndihme janë:

- Sëmundjet e rënda të konstatuara nga konziliumi i mjekëve apo fletëlëshimi i spitalit,
- Gjendja e rëndë ekonomike dhe familjare e dëshmuar,
- Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve të tjera,
- Dëshmia - procesverbali për dëmet nga fatkeqësitë natyrore, nga komisioni profesional, dhe

- Dëshmi të tjera sipas përcaktimeve me vendim të veçant të komunës në varshmëri nga lloji i ndihmës dhe formës së ndarjes së mjeteve.

Neni 13

Organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave të kompletuara, është Komisioni i formuar nga ana e Ekzekutivit Komunal, i cili propozon ndihmën momentale.

Kërkesat e pa kompletuara, komisioni nuk do t'i procedoj.

Kërkesat që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me këtë rregullore do të refuzohen nga Kryetari i Komunës sipas propozimit të Komisionit.

Neni 14

Lartësia e shumës për ndihmë momentale për entitetet jo publike është nga 50,00 € -200,00 € / me shkronja: pesëdhjetë deri në dyqindë euro /, që do të propozohet nga Komisioni.

Kërkuesi i kësaj ndihme mund të ndihmohet vetëm një herë gjat një viti.

Neni 15

Komisioni, listen e propozuar për ndihma momentale ia dorëzon drejtorit përkatës të Ekzekutivit Komunal, i cili mund ta ndryshoj para se t'i dorëzohet për miratim Kryetarit të Komunës, nëse ka fakte të pa kontestueshme.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 16

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e Ekzekutivit Komunal.

Neni 17

Kryetari i Komunës lejon ndarjen e subvencioneve për entitet publike dhe jo publike deri në shumë prej 1.000,00 € / me shkronja: njëmijë euro/.

Për shumat më të larta se ajo e përcaktuar me paragrafin paraprak vendos Kuvendi i Komunës apo KPF-ja, nëse autorizohet nga Kuvendi i Komunës.

Neni 18

Entitetet publike dhe jo publike janë të obliguara që për shumën e përfituar nga subvencionet dhe transferet, të paraqesin Raport me shkrim me dokumentacion shtesë, kryetarit të komunës dhe DEFZH, mbi shpënzimin e tyre.

Neni 19

Për të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar në këtë rregullore, vlejné dispozitat ligjore të cilat janë në fuqi nga kjo lëmi në Republikën e Kosovës.

Neni 20

Kjo rregullore hyn në fuqi m[miratimin e saj nga Kuvendi i Komunës, ndërsa do të zbatohet duke filluar nga muaji janar 2013.

**Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi**